

Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvillon sesion trajnimi me ekspertë të Bankës Botërore për forcimin e kapaciteteve në auditimin e projekteve

Në datën 26 Prill 2022, në mjediset e Hotel Plaza u zhvillua trajnimi mes audituesve të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja në KLSH dhe Bankës Botërore.

Sesionet e trajnimit kishin për qëllim të informonin audituesit e KLSH-së mbi kuadrin ligjor të prokurimeve të Bankës Botërore, përzgjedhjen e shërbimeve dhe të konsulencës, si edhe menaxhimin financiar në kuadrin e projekteve të financuara nga Banka Botërore.

Informacionet e marra do të shërbejnë në rritjen e kapaciteteve profesionale për auditimin e procedurave të prokurimit të projekteve të Bankës Botërore por edhe në dhënien e një informacioni më të hollësishëm mbi rregulloret e prokurimit dhe efektivitetin e auditimit të këtyre lloj procedurave.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në bashkëpunim me Bankën Botërore do të vijojë bashkëpunimin e mëtejshëm në këto fusha duke bërë të mundur që audituesit e KLSH-së të përftojnë nga praktikatat më të mira ndërkombëtare.

